

# MONITORIMI I PLURALIZMIT TË MEDIAS NË EPOKËN DIGITALE


## APLIKIMI I MONITORIMIT TË PLURALIZMIT TË MEDIAS NË BASHKIMIN EVROPIAN, SHQIPËRI, REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, MALIN E ZI, SERBI DHE TURQI.

Raport Kombëtar: Shqipëri

Kristina Voko, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri  
Besar Likmeta, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri

**Raporti i Projektit Studimor**

Edicioni -  
Qershor 2023



# TABELA E LËNDËS

<b>1. Rreth projektit</b>	<b>4</b>
1.1. Përmbledhje e projektit	4
1.2. Metodologjia	4
<b>2. Hyrje</b>	<b>6</b>
<b>3. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave: Vlerësimi i rrezikut ndaj pluralizmit të medias</b>	<b>8</b>
3.1. Mbrojtja Themelore (57% - rrezik mesatar)	11
3.2. Pluralizmi i Tregut (85% - rrezik i lartë)	15
3.3. Pavarësia Politike (68% - rrezik i lartë)	19
3.4. Gjithëpërfshirja Sociale (71% - rrezik i lartë)	22
<b>4. Konkluzione</b>	<b>25</b>
<b>5. Shënime</b>	<b>27</b>
<b>6. Referenca</b>	<b>28</b>
<b>Anekse I. Ekipi i studimit kombëtar</b>	
<b>Anekse II. Grupi i Ekspertëve</b>	

© European University Institute 2023

Përmbajtja dhe kapitujt specifikë © Kristina Voko, Besar Likmeta, 2023

Ky raport është publikuar nga European University Institute,  
Robert Schuman Centre for Advanced Studies.

Ky tekst mund të shkarkohet vetëm për përdorim personal kërkimor. Për riprodhimin e tij për qëllime të tjera, qoftë në print ose në version elektronik, nevojitet miratimi paraprak i autorëve. Në raste të citimit ose kuotimit, duhet të referohen emrat e plotë të autorëve, redaktorëve, titulli, viti dhe botuesi.

Kërkesat duhet të drejtohen në adresën [cmpf@eui.eu](mailto:cmpf@eui.eu)

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim reflektojnë opinionin individual të autorëve dhe jo ato të European University Institute.

The English version of this report prevails over this translation.

Centre for Media Pluralism and Media Freedom  
Robert Schuman Centre for Advanced Studies

Raporti i Projektit Studimor -  
RSC / Centre for Media Pluralism and Media Freedom  
Publikuar në Qershor 2023

European University Institute  
Badia Fiesolana  
I – 50014 San Domenico di Fiesole (FI)



Me mbështetjen e Programit Erasmus+ të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian mbështet EUI përmes buxhetit të BE-së. Ky publikim reflekton pikëpamjet e vetë autorëve dhe Komisioni Evropian nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo përdorim të mundshëm të informacionit që përfshihet në të.

# 1. Rreth projektit

## 1.1. Përmbledhje e projektit

Monitorimi i Pluralizmit të Medias (MPM) është një punë kërkimore që ka për qëllim identifikimin e rreziqeve potenciale ndaj pluralizmit të medias në vendet anëtare dhe vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe merr në konsideratë njëkohësisht mjedisin mediatik online dhe offline. Ky raport narrativ është realizuar brenda kuadrit të zbatimit të MPM-së në vitin 2022, nën një projekt të financuar nga veprimi përgatitor i Parlamentit Evropian. Projekti është zbatuar në 27 vende anëtare të BE-së si dhe në Shqipëri, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Turqinë, me mbështetjen e një granti të dhënë nga Bashkimi Evropian për Qendrën për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias (CMPF) pranë European University Institute.

## 1.2. Metodologjia

### Autorësia dhe rishikimi

Partnerët e CMPF-së, të cilët janë kërkues të pavarur dhe me eksperiencë në vendet përkatëse, kryejnë mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raporteve narrative, me përjashtim të rastit të Italisë ku mbledhja e të dhënave u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë nga skuadra e CMPF-së. Kërkimi është bazuar një një pyetësor dhe udhërrëfyes të standardizuar të zhvilluara nga CMPF-ja.

Në Shqipëri, CMPF-ja hyri në partneritet me Kristina Vokon dhe Besar Likmetën (Rjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri), të cilët kryen mbledhjen e të dhënave, llogaritën dhe komentuan mbi variablat në pyetësor dhe intervistuan ekspertët. Raporti është riparë nga stafi i CMPF-së. Për më shumë, për të siguruar se gjetjet janë të sakta dhe të besueshme, një grup ekspertësh kombëtarë në secilin vend rishikuan përgjigjet, në veçanti për pyetjet vlerësuese (shiko Aneksin II për listën e ekspertëve). Për një listë vendesh të përzgjedhura, raporti final i vendit u vlerësua nga një ekspert i pavarur vendor (shiko Aneksin III).

Rreziqet ndaj pluralizmit të medias vlerësohen në katër fusha kryesore tematike, të cilat konsiderohet se pasqyrojnë fushat kryesore të rrezikut për pluralizmin dhe lirinë e medias: Mbrojtja Themelore, Pluralizmi i Tregut, Pavarësia Politike dhe Gjithëpërfshirja Sociale. Rezultatet mbështeten në vlerësimin e një numri indikatorësh për secilën fushë tematike (shiko Tabelën 1 më poshtë).

Mbrojtja Themelore	Pluralizmi i Tregut	Pavarësia Politike	Gjithëpërfshirja Sociale
Mbrojtja e lirisë së shprehjes	Transparenca e pronësisë së medias	Pavarësia politike e medias	Aksesi i minoriteteve në media
Mbrojtja e të drejtës së informimit	Larmishmëria e ofruesve të medias	Autonomia editoriale	Mediat vendore/rajonale dhe ato komunitare
Profesioni i gazetarit, standardet dhe mbrojtja	Pluralizmi në tregjet digjitale	Media audiovizive, platformat online dhe zgjedhjet	Barazia gjinore në media
Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit të medias	Qëndrueshmëria e medias	Rregulimi shtetëror mbi burimet dhe mbështetja për sektorin e medias	Alfabetizmi mediatik
Shpërndarja universale e medias konvencionale dhe aksesi në internet	Pavarësia editoriale nga ndikimi tregtar dhe nga pronari	Pavarësia dhe financimi i mediave publike	Mbrojtja ndaj dizinformimit dhe gjuhës së urrejtjes

Tabela 1: Fushat dhe treguesit e Monitorimit të Pluralizmit të Medias

## **Dimensioni digjital**

*Monitorimi nuk e konsideron dimensionin digjital si një fushë të izoluar, por si të ndërthurur me median tradicionale dhe parimet ekzistuese të pluralizmit të medias dhe lirisë së shprehjes. Pavarësisht kësaj, Monitorimi lejon llogaritjen më vete të rrezikut specifik për fushën digjitale, ndërsa raporti përmban një analizë specifike të rreziqeve në mjedisin informativ online.*

## **Përlllogaritja e rrezikut**

*Rezultatet për çdo fushë tematike dhe tregues prezantohen në një shkallë nga 0 në 100%.*

*Vlerësimi nga 0 deri në 33%: rrezik i ulët,*

*Vlerësimi nga 34 deri në 66%: rrezik i mesëm*

*Vlerësimi nga 67 deri në 100%: rrezik i lartë.*

Në nivelin e treguesve, pikët 0 vlerësohen 3% dhe pikët 100 vlerësohen 97% si rregull, për të shmangur një vlerësim sipas të cilit nuk ka fare rrezik ose siguri.

## **Ndryshimet metodologjike**

Për çdo edicion të MPM-së, CMPF përditëson dhe përmirëson pyetësoin, bazuar në vlerësimin e instrumentit pas zbatimit, rezultatet e procesit të mëparshëm të mbledhjes së të dhënave dhe ekzistencës së të dhënave të reja. Për MPM 2023, nuk ka pasur ndryshime të mëdha në pyetësor me përjashtim të treguesve të Transparencës në pronësinë e medias, Pluralizmit në tregjet digjitale dhe Pavarësia editoriale dhe ndikimi i pronarëve (fusha e Pluralizmit të Tregut) dhe Mbrojtja ndaj diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes (fusha e Gjithëpërfshirjes Sociale). Për rrjedhojë, rezultatet e marra nga këto tregues nuk janë ngushtësisht të krahasueshëm me rezultatet e marra në edicionet e mëparshme të MPM-së. Ndryshimet metodologjike shpjegohen në faqen e internetit të CMPF-së në: <http://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor/>.

Te fusha e Pluralizmit të Tregut, emrat e tre treguesve kanë ndryshuar. Treguesi i mëparshëm: "Përqendrimi në median informative" tani quhet: "Pluralizmi i ofruesve të medias"; "Platformat online dhe zbatimi i konkurrencës" është riemëruar "Pluralizmi në tregjet digjitale"; "Ndikimi tregtar dhe i pronarëve në përmbajtjen editoriale" është riemëruar "Pavarësia editoriale nga ndikimi tregtar dhe nga pronari".

**Heqje e përgjegjësive:** *Përmbajtja e raportit jo domosdoshmërisht përfaqëson këndvështrimin e CMPF-së dhe të KE-së dhe as nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e anëtarëve që përbëjnë Grupin e Ekspertëve. Ai vetëm prezanton mendimet e skuadrës kombëtare të vendit përkatës që kryen mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raportit. Për shkak të përditësimeve dhe shtjellimeve të pyetësorit, pikët e dhëna në MPM2023 mund të mos jenë tërësisht të krahasueshme me edicionet e mëparshme të MPM-së. Për më shumë detaje, shikoni raportin e CMPF-së më MPM2023, i cili do të jetë i disponueshëm së shpejti në: <http://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor/>.*

## 2. Hyrje


- **Të përgjithshme:** Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28,748 kilometrash katrorë dhe një popullsi prej 2.8 milionë banorësh. Ajo gjendet në Ballkanin Perëndimor përgjatë brigjeve të Detit Adriatik dhe Detit Jon dhe kufizohet me Malin e Zi dhe Kosovën në veri, me Maqedoninë e Veriut në Lindje dhe me Greqinë në jug.
- **Gjuhët:** Shqipja është gjuha zyrtare e vendit dhe ajo flitet nga 98.8% e popullsisë. Gjuhë të tjera të folura nga minorancat përfshijnë greqishten, gjuhën rome dhe vllahishten. Gjuha shqipe është e ndarë në dy dialekte, toskë e folur në jug dhe gegë e folur në veri.
- **Minoritetet:** Popullsia shqiptare përbëhet përgjithësisht nga shqiptarë etnikë dhe vetëm 1.5% banorëve renditen si minoritete etnike (INSTAT, 2012). Të dhënat e censusit të vitit 2011 mbeten kontroverse për shkak se vetëm 83.2% e të intervistuarve e deklaruan veten shqiptarë ndërsa 14.07% refuzuan t'i përgjigjen pyetjeve me bazë etninë. Një census i planifikuar për vitin 2020 është shtyrë për vitin 2023, për shkak të pandemisë COVID-19, zgjedhjeve dhe problemeve në fushën e prokurimit publik. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2017 Për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike në Republikën e Shqipërisë<sup>[1]</sup>, minoritetet e njohura etnike dhe/ose kulturore në Shqipëri përfshijnë: grekët, maqedonasit, arumunët, romët, egjiptianët, malazezët, boshnjakët, serbët dhe bullgarët. Minoriteti më i madh në Shqipëri është ai grek, i cili është përqendruar kryesisht në kufirin jugor të Shqipërisë me Greqinë, pasuar nga ai maqedonas, i cili gjendet përreth brigjeve të Liqenit të Prespës në perëndim si dhe minoriteti kulturor rom.
- **Situata ekonomike:** Prodhimi i Brendshëm Bruto u rrit me 8.5% gjatë vitit 2021, ushqyer nga ringritja e sektorit të turizmit dhe mikpritjes dhe kërkesës së theksuar të brendshme. Ekspansioni ekonomik vijoi në tremujorin e parë të vitit 2022, kur prodhimi u rrit me 6.5% para se të ngadalësohej në 2.2% në tremujorin e dytë, për shkak të mungesës së investimeve private. Pavarësisht rritjes së inflacionit për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve në të gjithë botën, kursi i këmbimit ka qëndruar stabil. Norma e inflacionit gjatë vitit 2022 ishte më e larta në njëzet vjet dhe ka pasur efekt negativ në konsumin e familjeve. Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua në gjysmën e parë të vitit 2022 dhe rritja e eksporteve në mallra dhe shërbime kompensoi rritjen e importeve, gjë që mbështeti stabilitetin e kursit të këmbimit. Rritja e PBB-së për vitin 2023 është projektuar në masën 2.5%. Banka qendrore shtrëngoi politikën monetare katër herë në dhjetë muajt e vitit 2022, duke rritur normën bazë nga 0.5% në mars në 2.25% në tetor, për shkak të rritjes së shqetësimeve të sigurisë energjetike pas fillimit të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2023).
- **Situata politike:** Viti 2022 u karakterizua nga skandale korrupsioni të nivelit të lartë, emigrim dhe konsolidim të mëtejshëm të pushtetit nga Partia Socialiste e kryeministrit Edi Rama (Erebara 2022a). Pas arrestimit të ish-Ministrit të Mjedisit Lefter Koka në dhjetor 2021, deputeti socialist Alqi Billako u arrestua në prill në lidhje me një skandal mbi menaxhimin e plehrave, i cili dërgoi edhe një duzinë zyrtarësh të qeverisë pas hekurave. Në shkurt 2022, ish-Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, u dënua për abuzim me detyrën për ndihmë dhe nxitje të trafikantëve të drogës, nga të cilët ai mori dhurata. Në korrik 2022, ish-kryebashkiaku socialist i bashkisë Lushnjë u dënua në akuza për korrupsion. Pavarësisht arrestimeve dhe dënimeve, u ngritën pikëpyetje mbi pavarësinë e sistemit të drejtësisë, i cili po i nënshtrohet një reforme madhore që ka vijuar që prej disa vitesh. Në fund të vitit, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, ngriti shqetësime mbi ndërhyrje të papërshtatshme në procesin e

përzgjedhjes së kreut të ri të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Opozita shqiptare mbeti thellësisht e ndarë gjatë vitit 2022, mes mbështetësve dhe kundërshtarëve të ish-kryeministrit Sali Berisha – i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara për korrupsion, ndërsa mazhoranca në pushtet konsolidoi më tutje pushtetin. Më shumë se 15 mijë shqiptarë emigruan ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar gjatë vitit 2022, shpesh duke kapërcyer Kanalin Anglez me gomone, gjë që përbën një nga valët më të mëdha migratore të viteve të fundit. Në një drejtim pozitiv, në korrik 2022, pas shumë vonesash, Këshilli i Bashkimit Evropian nisi konferencën e parë ndërqeveritare si pjesë e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Komisioni menjëherë nisi procesin e rishikimit (Komisioni Evropian, 2022). Shqipëria kundërshtoi ashpër agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe u bashkua me BE-në dhe SHBA-në në imponimin e sanksioneve kundër Moskës.

- **Tregu i medias:** Pavarësisht numrit të lartë të televizioneve dhe të mediave online, përqendrimi i tregut dhe i audiencës dhe mungesa e transparencës në financimin e medias vijojnë të mbeten një problem shqetësues sa i përket lirisë së medias në vend. Ndërkohë tregu i gazetave është tkurrur ndjeshëm përgjatë pak viteve të fundit ndërsa në 2022, vetëm shtatë gazeta të përditshme ishin në qarkullim. (Komisioni Evropian, 2022).
- **Mjedisi rregullues:** Megjithëse nuk ka pasur ndryshime në mjedisin rregullator të medias gjatë vitit 2022, në nëntor shumica socialiste njoftoi se ajo po tërhoqte nga parlamenti një projektligj kontrovers që synonte të amendonte Ligjin Për Median Audiovizive. Nëse do të miratoheshin, ndryshimet do të fuqizonin Autoritetin e Medias Audiovizive të rregullonte përmbajtjen e mediave online dhe të vendoste gjoba të rënda. Projektligji u kundërshtua nga organizatat vendëse dhe ndërkombëtare të të drejtave, të cilat paralajmëruan se ai do të kishte një efekt frikësues mbi lirinë e medias në Shqipëri (European Centre for Press and Media Freedom, 2022).
- **COVID-19:** Në vitin 2022, Shqipëria regjistroi 122,088 raste infektimesh me koronavirusin e ri. Nga fillimi i pandemisë deri më 31 dhjetor 2022, 3,569 viktima u regjistruan nga COVID-19. Vetëm në 2022 pati 378 viktima (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, 2023).

### 3. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave: Vlerësimi i rrezikut ndaj pluralizmit të medias

#### Shqipëri: Fushat e Rrezikut të Pluralizmit të Medias



JS chart by amCharts



Rreziku ndaj lirisë dhe pluralizmit të medias varioi nga i mesëm në i lartë në Shqipëri gjatë vitit 2022 në katër fushat e vlerësuara nga treguesit e Monitorimit të Pluralizmit të Medias. Skena mediatike u vlerësua me rrezik të lartë në fushat e Pluralizmit të Tregut (85%), Pavarësisë Politike (68%) dhe Gjithëpërfshirjes Shoqërore (71%) ndërsa vlerësimi ishte për rrezik të mesëm vetëm në fushën e Mbrojtjes Themelore (57%).

Shqipëria vlerësohet me rrezik të mesëm (57%) në lidhje me fushën e **Mbrojtjes Themelore**. Megjithëse kuadri ligjor ofron masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes në kushtetutë, në Ligjin për Median Audiovizive dhe përmes konventave ndërkombëtare, masat korigjuese ligjore në rastet e shkeljes së të drejtave të tilla nuk janë gjithmonë efikase. Në praktikë, gjatë vitit 2022, ka pasur dhunim sistematik të lirisë së shprehjes në vend. Shpifja nuk është dekriminalizuar tërësisht dhe mbetet e dënueshme me gjobë, ndërsa vendimet e gjykatave për zhdëmtim shpesh janë disproporcionale, duke sjellë ngritjen e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Megjithëse autoriteti i medias, në teori duhet të jetë i pavarur nga presioni politik dhe korporativ, në praktikë, procedurat aktuale të emërimit nuk e minimizojnë rrezikun e ndërhyrjes politike apo ekonomike dhe fuqia e autoritetit nuk përdoret në një mënyrë të pavarur.

Në fushën e **Pluralizmit të Tregut** Shqipëria vlerësohet me 85% në vitin 2022 dhe, njësoj si në vitin paraardhës, është me rrezik të lartë. Medias në Shqipëri i mungon pavarësia nga interesat politike dhe tregtare të pronarëve, gjë që dëmton cilësinë e gazetarisë. Pronësia dhe financimi i medias nuk ka transparencë. Përqendrimi i tregut dhe i audiencave në median audiovizive në duart e pak mediave të fuqishme në pronësi familjare, vijon të mbetet një problem shqetësues në lidhje me lirinë e medias.

Në fushën e **Pavarësisë Politike**, në 2022 Shqipëria vlerësohet me rrezik të lartë në masën 68%. Legjislativi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por administrata publike, në mënyrë sistematike, u mohon gazetarëve aksesin në informacion në mënyrë arbitrare. Organizatat profesionale të gazetarëve dhe Këshilli i Medias janë disi efektive; gjithsesi, punonjësit e medias shpesh përballen me




vonesa në pagesa dhe me një mungesë të përgjithshme të sigurisë në punë. Mungesa e sigurisë në punë dhe kushtet e këqija të punës i kanë bërë gazetarët të prekshëm nga vetëcensura dhe më pak të fortë përballë dizinformimit. Disa media audiovizive dhe gazeta kontrollohen politikisht dhe ka pasur raste të sinjalizuara për ndërhyrje politike në emërimin e kryeredaktorëve. Masat vetërregulluese që synojnë pavarësi editoriale nga ndërhyrja politike në median informative nuk zbatohen në mënyrë efikase, ndërsa raportohen edhe ndërhyrje sistematike nga politikanët në çështje të përmbajtjes editoriale.

Fusha e **Gjithëpërfshirjes Sociale** vlerësohet si me rrezik të lartë, (71%), me një ndryshim ky nga viti 2021, kur vlerësimi ishte 64%. Politikatat e alfabetizimit mediatik në Shqipëri mbeten të nënzhvilluara dhe jo mirë të zbatuara. Megjithatë herë pas here ka trajnime për mësuesit në alfabetizimin mediatik, dhe disa leksione janë të disponueshme përmes arsimit joformal, këto nuk shënjestrojnë grupet vulnerabël. Si në median publike ashtu edhe në atë private ka mungesë barazie gjinore në përfaqësimin e minoriteteve.

Ndikimi i pandemisë **COVID-19** në pluralizmin e medias u pakësua gjatë vitit 2022 në krahasim me vitin e mëparshëm, pas heqjes së kufizimeve mbi aksesin e gazetarëve në institucionet publike. Gjithsesi fushatat e lajmeve të rreme dhe teoritë konspirative në lidhje me pandeminë dhe vaksinat, për shkaqe ideologjike dhe ekonomike, vijuan.

## Fokusi në mjedisin digjital




Vlerësimi i pluralizmit të medias në mjedisin digjital e klasifikon Shqipërinë më 2023 si vend me rrezik të lartë në të gjithë treguesit. Tre fusha janë vlerësuar me rrezik edhe më të lartë në sferën digjitale në krahasim me të gjithë median, ndërsa Mbrojtja Themelore ka të njëjtin vlerësim në mjedisin digjital me të gjithë median. Në lidhje me median digjitale në Shqipëri, **Mbrojtja Themelore** vlerësohet në rrezik të ulët me 57%, e njëjtë me të gjithë median. Fusha e Pavarësisë Politike ka dallimin më të madh mes medias digjitale dhe medias në tërësi, me 29 pikë përqindjeje, pasuar nga Gjithëpërfshirja Shoqërore

me 14 pikë përqindjeje. Fusha e **Pavarësisë Politike** online vlerësohet me nivel rreziku 97% në krahasim me 68% për të gjithë median dhe **Gjithëpërfshirja Sociale** vlerësohet me 84% në mjedisin digjital, në krahasim me 71% për të gjithë median në të njëjtën fushë. **Pluralizmi i Tregut** shënoi vlerësimin 93% në mjedisin digjital dhe vlerësimin 85% për të gjithë median. Fusha e Pluralizmit të Tregut në sferën digjitale shënoi rrezik të lartë për shkak të mungesës së të dhënave mbi pronësinë, të ardhurat dhe ndarjen e tregut. Gjithashtu, kjo fushë vlerësohet si me rrezik të lartë edhe për shkak të transparencës së munguar mbi të ardhurat nga reklamat nga platforma të tilla si Meta dhe Google dhe nga mungesa e parashikimeve në legjislacion të cilat mund të sjellin një shkallë të lartë të përqendrimit të pronësisë ndërsektoriale mbi media të ndryshme. Kontrolli politik mbi median digjitale vlerësohet gjithashtu si me rrezik të lartë. Megjithëse Shqipëria raportohet të ketë qindra media digjitale, këto të fundit janë akuzuar shpesh për përhapje lajmesh të rreme dhe dizinformimi për llogari të interesave të fshehura. Vlerësimi për fushën e Gjithëpërfshirjes Shoqërore në sferën digjitale mbetet me rrezik të lartë më 2022, për shkak të mungesës së aftësive digjitale nga popullsia e gjerë dhe efikasitetit të kufizuar të mekanizmave rregulluese dhe vetërregulluese për të raportuar gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën diskriminuese, veçanërisht përkundrejt minoriteteve dhe komunitetit LGBTI.

### 3.1. Mbrojtja Themelore (57% - rrezik mesatar)

Treguesit e Mbrojtjes Themelore përfaqësojnë shtyllën kurrizore rregullatore në sektorin e medias në çdo demokraci bashkëkohore. Ata masin një numër fushash potenciale me rrezik, përfshirë ekzistencën dhe efikasitetin e zbatimit të masave mbrojtëse rregullatore për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim; statusin e gazetarëve në çdo vend, përfshirë mbrojtjen dhe aftësinë për të punuar; pavarësinë dhe efikasitetin e organeve rregullatore kombëtare që kanë kompetencë për të rregulluar sektorin e medias dhe përhapjen e medias tradicionale e aksesin në internet.



Shqipëria vlerësohet me rrezik të mesëm në fushën e **Mbrojtjes Themelore** (57%). Asnjë nga pesë treguesit nuk u vlerësua me rrezik të ulët ose të lartë, por rreziku më i lartë në këtë fushë u shënuar në treguesin e Mbrojtjes së të drejtës për informim (65%). Megjithatë kuadri rregullator në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi i dobët i tij përkthehet në kufizime arbitrare të së drejtës për informim dhe lirisë së shprehjes.

Neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes dhe të shtypit, të radios dhe televizionit dhe në mënyrë eksplicite parandalon censurën paraprake të mjeteve të informimit. Shqipëria ka ratifikuar pa rezerva edhe shumë konventa ndërkombëtare, të cilat garantojnë lirinë e shprehjes. Pavarësisht garancive ligjore të lirisë së shprehjes, në praktikë, ka dhunime sistematike të **Mbrojtjes së lirisë së shprehjes** (57%). Në Indeksin e Lirisë së Medias për vitin 2022, publikuar nga Reporterë pa Kufij, (RSF), Shqipëria renditet në vend të 103-të nga 180 vende të vlerësuara, me 56.41 pikë (Reporterë pa Kufij, 2022). Shqipëria humbi 20 pozicione në indeks në krahasim me vitin 2021 kur renditej në vend të 83-të nga 180 vende. Raporti nënvizoi se pavarësia editoriale e medias kërcënohet nga rregullimi partizan i medias, ndërsa integriteti fizik i gazetarëve minohet nga krimi i organizuar, nga dështimi i shtetit për t'i mbrojtur ata, madje edhe nga dhuna policore. Sipas RSF-së, panorama e medias shqiptare dominohet nga media nën pronësinë e një grushti kompanish private, të cilat kanë lidhje me politikanët dhe, në të njëjtën kohë, operojnë në sektorë shumë të rregulluar, të tillë si ndërtimi. Megjithatë ka qindra media online në vend, vetëm një numër shumë i vogël i tyre kanë modele të qëndrueshme biznesi dhe financim transparent. Raporti për Shqipërinë i Komisionit Evropian për vitin 2022 (Raporti i Komisionit Evropian 2022), shkruan se pavarësia e medias dhe cilësia e gazetarisë mbeten të penguar nga ndërthurja e interesave të biznesit dhe të politikës. Fushatat dizinformuese janë të shpeshta, veçanërisht online, ndërsa gazetarët që raportojnë

mbi çështjet e shtetit të së drejtës, korrupsionit dhe drejtësisë, përballen me kërcënime, kanosje dhe fushata sulmesh online.

Treguesi i **Mbrojtjes së të drejtës për informim** u vlerësua me rrezik të mesëm (64%) më 2022. E drejta për informim në Shqipëri njihet si nga Kushtetuta (neni 23) ashtu edhe nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Shumica e kufizimeve mbi aksesin në informim janë përkufizuar në ligj. Megjithatë, disa parashikime nuk janë të qarta, veçanërisht ato të lidhura me aksesin në informacion në institucionet e drejtësisë. Bazuar në Raportin Monitorues të Hartës së Lirisë së Medias 2022, gazetarët në Shqipëri punojnë në një mjedis kufizues sa i përket aksesit në informacion nga burime qeveritare dhe gazetarëve që shihen si përfaqësues të “opozitës”, u mohohet akreditimi apo ndalohen nga mundësia për të bërë pyetje në konferenca për shtyp (Reagimi i Shpejtë i Lirisë së Medias 2023). Mohimi në akses në informacion mund të apelohej te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe në Gjykatën Administrative, por këto mekanizma marrin shumë kohë dhe jo gjithmonë janë efikase për shkak se vendimet e Komisionerit nuk janë detyruese për zyrtarët publikë. Procedurat janë të mëdha dhe keqpërdorimi sistematik nga ana e administratës publike, të cilat shkaktojnë vonesa për të kufizuar aksesin në informacion (Komisioni Evropian, 2022). Agjencia e re për Media dhe Informim (MIA) e krijuar më 2021, ka shtrënguar edhe më tej kontrollin dhe ka centralizuar fluksin e informacionit edhe më shumë (European Centre for Press and Media Freedom, 2022). Megjithatë mbrojtja e sinjalizuesve është e rregulluar, ligji mbron vetëm anëtarët e sektorit publik apo privat që raportojnë brenda institucionit apo tek agjencia qeveritare - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe të Konfliktit të Interesit (ILDKPKPI). Ligji nuk lejon ekspozimin publik apo në media në asnjë rrethanë. Pavarësisht një numri aktivitetesh që synonin rritjen e ndërgjegjësimit të zhvilluara më 2021, numri i ankesave mbeti i ulët.

Treguesi i **Profesionit të gazetarit, standardeve dhe mbrojtjes (64%)** klasifikohet si me rrezik të mesëm më 2022. Pavarësisht përpjekjeve më të mira të shoqatave në Shqipëri dhe të Këshillit të Medias për të përmirësuar pavarësinë editoriale, ato nuk janë ende organizata të konsoliduara dhe kanë burime dhe kompetenca të kufizuara. Ky tregues është gjithashtu i ndikuar negativisht nga kushtet e vështira të punës për gazetarët dhe punonjësit e medias në përgjithësi. Sipas Barometrit Kombëtar për Lirinë e Shprehjes (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2022), 12.5% e gazetarëve raportojnë se nuk kanë një kontratë të përshtatshme pune me punëdhënësit. Në të njëjtën kohë, 21% e të intervistuarve në vrojtim raportuan se paga e tyre nuk paguhet e plotë në bankë, por pjesërisht jepet *cash*, gjë që është në shkelje të Kodit të Punës. Sipas Raportit të Progresit të Shqipërisë (Komisioni Evropian 2022), mungesa e kontratave të punës me forcë shtrënguese vijon të mbetet një problem, veçanërisht për median vendore dhe atë online. Sipas të dhënave të ofruara nga Unioni i Gazetarëve, një e katërta e punonjësve të medias janë duke punuar pa kontratë. Raportohet se rreth 80% e gazetarëve paguhet me pagë minimale dhe gati 48% të pagave vonohen nga 2 deri në gjashtë muaj. Sipas Platformës për Gazetarët e Sigurt (Këshilli i Evropës, 2023), mes tetë alarmeve të regjistruara në Shqipëri, tre lidheshin me sulme fizike kundër gazetarëve në 2022. Për të njëjtën periudhë, Platforma e Hartës së Lirisë së Medias regjistroi së paku pesë sulme fizike (tre prej tyre me lëndime), që përfshinin 11 gazetarë dhe profesionistë të medias (European Centre for Press and Media Freedom, 2023). Kanosja e gazetarëve gjatë vitit 2022 u bë nga zyrtarë të lartë shtetërorë dhe oficerë policie. Rasti më serioz ishte kanosja e gazetarit të A1 CNN Klevin Muka nga kryeministri Edi Rama. Muka u ndalua nga konferencat për shtyp të qeverisë dhe u dërgua për “riedukim” pasi pyeti konkretisht për një konflikt interesi të ministres së punëve të jashtme (SafeJournalists Network, 2022a).

Treguesi **Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit të medias** u vlerësua me 42% në 2022, i njëjti nivel rreziku me vitin 2021. Ky vlerësim lidhet kryesisht me perceptimin në komunitetin mediatik vendas se Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) nuk është i pavarur dhe emërimi i anëtarëve të bordit nuk është i lirë nga ndikimi

politik, për shkak se emërimi i tyre mund të kryhet me një shumicë të thjeshtë parlamentare. Në shkurt 2022, parlamenti plotësoi gjashtë vakanca nga njëmbëdhjetë anëtarë të bordit të Autoritetit të Medias Audiovizive, ndërsa pavarësia e disa prej anëtarëve të rinj të AMA-s u vu në pikëpyetje për shkak të lidhjeve dhe afilimeve të tyre politike (Komisioni Evropian, 2022).

Treguesi **Shpërndarja universale e medias konvencionale dhe aksesit në internet** u vlerësua me 56% dhe renditet me rrezik të mesëm. Në vitin e mëparshëm, ky tregues u vlerësua me 75% dhe u klasifikua si me rrezik të lartë. Përmirësimi në nivelin e rrezikut për këtë tregues ka ardhur si pasojë e rritjes së mbulimit me bandë të gjerë në vend.

## Fokusi në mjedisin digjital

Megjithëse media online në Shqipëri nuk përkufizohet qartë dhe nuk rregullohet me ligj, praktika gjyqësore nuk bën dallim mes tyre dhe medias së shtypur dhe audiovizive. Përgjatë viteve të fundit, qeveria shqiptare ka bërë përpjekje të përsëritura për të zgjeruar fushën e veprimit të Ligjit për Median Audiovizive në mënyrë që të rregullojë përmbajtjen e medias online. Në nëntor 2022, Kuvendi i Shqipërisë hoqi nga axhenda një seri amendimesh kontroverze në Ligjin e Medias Audiovizive, të cilat synonin të fuqizonin Autoritetin e Medias Audiovizive për të vlerësuar përmbajtjen e publikuar nga media online, me fuqinë për të vendosur gjopa të rënda. Ligji u kundërshtua nga grupimet vendase dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve. Komisioni i Venecias (2020) paralajmëroi se nëse do të miratoheshin, këto parashikime do të kishin efekt frikësues për lirinë e medias. Gjatë vitit 2022, qeveria shqiptare e ka përmbajtur veten nga bllokimi, filtrimi, apo monitorimi i internetit në mënyrë arbitrare. Nuk ka publikim të të dhënave mbi filtrimin apo bllokimin e një përmbajtjeje të mundshme të paligjshme nga institucionet shtetërore. Gjithsesi, platformat e internetit, të tilla si Facebook, herë pas here kanë filtruar përmbajtje të verifikuar nga kontrolluesit e pavarur të fakteve si lajme të rreme apo dizinformim.

Sipas databazës së mbajtur nga Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe të Medias (2023), ka pasur tre raste ngacmimesh online kundër gazetarëve në Shqipëri më 2022. Këto përfshijnë kërcënime dhe kanosje kundër punonjësve të medias nga një zv/komisar policie në qytetin e Elbasanit dhe thyerje të të dhënave personale të një gazetari nga rrjeti BIRN, gjë që duket të jetë e lidhur me raportimet e tij mediatike. Nuk ka pasur raste të raportuara për ngacmime online kundër gazetarëve gra gjatë vitit 2022 të regjistruara në Shqipëri. Gjithsesi, raporte të mëparshme kanë sinjalizuar se gratë gazetare kanë qenë shumë ngurruese për të denoncuar rastet.


Ligji në Shqipëri sanksionon detyrim për ruajtje të dhënash për operatorët e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit të internetit, gjë që nuk përputhet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Legjislacioni kombëtar në Shqipëri nuk siguron balancën e duhur mes mbrojtjes së të dhënave dhe lirisë së shprehjes sa i përket aktiviteteve të gazetarëve. Sipas Komisionit Evropian (2022) në raportin e vendit, mbrojtja e të dhënave personale nga legjislacioni shqiptar ka ende nevojë të përafrohet me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR) dhe direktivën e lidhur me të "për zbatimin e ligjit" 2016/680. Një projektligj që synon të arrijë këtë përafrim është dorëzuar për konsultim publik, por nuk është votuar ende në parlament.

Më shumë se 96.5% e familjeve shqiptare kishin akses në internet më 2022, në krahasim me 88.35 në vitin e mëparshëm. Vlerësohet se 90.3% ose 665,362 familje kanë lidhje fikse me brez të gjerë në internet (fibër optike apo rrjet kabllor, ADSL etj.), ky tregues ka shënuar rritje me 12 pikë përqindjeje. Rreth 99.25 e familjeve kanë internet përmes lidhjeve celulare me bazë të gjerë (3G/4G, tabletë, etj.)

në krahasim me 99.1% më 2021 (INSTAT, 2023).

### 3.2. Pluralizmi i Tregut (85% - rrezik i lartë)

Pluralizmi i Tregut merr parasysh dimensionin ekonomik të pluralizmit të medias, duke vlerësuar rrezikun që rrjedh nga transparenca e pamjaftueshme e pronësisë së medias, përqendrimin të tregut në terma si të prodhimit, ashtu edhe të shpërndarjes, qëndrueshmërisë së prodhimit të përmbajtjes mediatike dhe ndikimit të interesave tregtare dhe të pronësisë në përmbajtjen editoriale. Aktorët e përfshirë në vlerësim janë ofruesit e përmbajtjes mediatike, me tregues që përfshijnë Transparencën e pronësisë së medias, Larmishmërinë e ofruesve të medias, Qëndrueshmërinë e medias, Pavarësinë editoriale nga ndikimet komerciale apo nga pronarët dhe, ndërmjetësit digjitalë (me treguesin e Pluralizmit në tregjet digjitale).



Në vitin 2022, treguesit në fushën e **Pluralizmit të Tregut** u vlerësuan me rrezik të lartë (85%), pothuajse në të njëjtin nivel rreziku të shënuar në vitin paraardhës. Të gjithë treguesit e kësaj fushe u vlerësuan si me rrezik të lartë më 2022, ku treguesi i Pluralizmit në tregjet digjitale u vlerësua me rrezik veçanërisht të lartë (97%). Tregu digjital në Shqipëri nuk është i rregulluar dhe, për rrjedhojë, nuk ka asnjë raportim zyrtar, as nga autoritetet dhe as nga kompanitë. Kjo sjell mungesë të dhënash, gjë që vlerësohet si rrezik dhe redukton transparencën e tregut të medias në përgjithësi.

Treguesi i **Transparencës së pronësisë së medias** u vlerësua 81%, me rrezik të lartë, gjë që nuk ka ndryshuar përgjatë dy viteve të fundit. Kuadri ligjor shqiptar<sup>[2]</sup> nuk përmban parashikime specifike mbi transparencën e pronësisë së medias, me përjashtim të transmetuesve audiovizivë, të cilët janë të detyruar të regjistrohen si ente juridike të veçanta. Të dhëna të tilla mblidhen dhe shpërndahen nga Autoriteti i Medias Audiovizive, por është gjithashtu e mundur të kesh qasje në këtë informacion përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit për median audiovizive, por vetëm për shumë pak media të tjera. Amendime të reja në Ligjin e Medias Audiovizive<sup>[3]</sup> janë propozuar dhe konsultuar gjatë vitit 2022, me synimin për ta përshtatur atë me Direktivat 2010/13/EU dhe 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian. Këto amendime synojnë të rrisin transparencën e pronësisë së medias, veçanërisht në lidhje me përfituesit fundorë. Nga ana tjetër, mediat vetëm digjitale nuk rregullohen në Shqipëri dhe detyrimi i tyre i vetëm është regjistrimi i domeinit, gjë që mund të bëhet nga një individ apo një kompani/ent jofitimprurës. Për rrjedhojë, transparenca e pronësisë së medias vijon të jetë rekomandimi kryesor dhe i përsëritur i Komisionit Evropian (2022) dhe i organizatave partnere të Platformës së Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve (Qendra

Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias, 2022) kundrejt qeverisë shqiptare.

Treguesi i **Larmishmërisë së ofruesve të medias** vlerësohet me rrezik të lartë dhe shënoi në vitin 2022 nivelin 90%. Ky tregues nuk ka shënuar përmirësim në krahasim me vitin 2021. Megjithëse Ligji i Medias Audiovizive përmban koncepte mbi kufizimin e pronësisë së aksioneve/të drejtave votuese në lidhje me një kompani të dytë mediatike, për median e shtypur dhe atë online nuk ka legjislacion për kufizim specifik dhe/ose kufizime të tjera. Në lidhje me median audiovizive, kufizime janë vendosur në përqindjen e kapitalit total (20%) në një kompani të dytë që ka një licencë kombëtare, ndërsa për median analoge audiovizive, pjesëmarrja maksimale e lejuar në një media të tretë me licencë kombëtare kufizohet në 10% të kapitalit të asaj kompanie mediatike. Ligji i medias audiovizive përmban kufizime të natyrës komerciale, në lidhje me ndalimin e zënies së një pjese më të madhe se 30% në tregun e reklamave nga një kompani që ka një licencë kombëtare audio apo audiovizive (RSF, BIRN Albania, 2018). Autoriteti i Medias Audiovizive në Shqipëri dhe Autoriteti i Konkurrencës nuk japin të dhëna mbi ndarjen e tregut në këtë sektor. Ligji i medias audiovizive nuk ka ndonjë parashikim në lidhje me publikimin e informacionit mbi këtë treg. Gjithsesi, të dhënat e analizuara nga BIRN Albania, mbështetur në deklaratat financiare të vitit 2021, tregojnë se katër mediat kryesore audiovizive kontrollojnë 77% të tregut dhe dy prej tyre kontrollojnë 63.3%, respektivisht, TV Klan me 35.6% dhe Top Channel me 27.7% (Erebara, 2022b).

Treguesi **Pluralizmi në tregjet digjitale** renditet si me rrezik të lartë me 97%. Në përgjithësi, nuk ka të dhëna mbi përqendrimin e tregut të reklamave online në ekosistemin e ri të medias, përfshirë platformat, medias tradicionale me prani në internet apo medias vetëm në internet. Të dhënat nuk janë të disponueshme as për pjesën e audiencës së lojtarëve kryesorë në tregun digjital. Një shkallë e lartë përqendrimi të pronësisë në median digjitale dhe në tregun e reklamave digjitale nuk mund të parandalohet përmes zbatimit të rregullave për mbrojtjen e konkurrencës, për shkak se Autoriteti i Konkurrencës në një vendim të vitit 2017, deklaroi se ai nuk ka kompetencë për të vlerësuar një ankesë kundër më mediaje audiovizive, për shkak se fusha e medias bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Autoritetit të Medias Audiovizive. Vendimi kuptohet se vlen edhe për median digjitale. Në Shqipëri nuk ka kuadër ligjor specifik për rregullimin e tregut të reklamave digjitale. Në Shqipëri nuk ka masa për të promovuar shpërbimin e publikuesve nga platformat digjitale dhe sistemi fiskal në Shqipëri nuk ka vendosur dhe as ka planifikuar të vendosë ndonjë taksim në shërbimet digjitale gjatë vitit 2022. Platformat digjitale dhe ndërmjetësit, si motorët e kërkimit dhe rrjetet e medias sociale, mbeten të parregulluara në Shqipëri dhe të paregjistruara në autoritetet fiskale, megjithëse përgjatë viteve të fundit ato kanë zënë një pjesë domethënëse të tregut të reklamave online.

Treguesi i **Qendrueshmërisë së Medias** vlerësohet me 67% më 2022 dhe klasifikohet si me rrezik të lartë. Për vlerësimin e këtij treguesi, në përgjithësi, nuk ka të dhëna të disponueshme për median e transmetuar apo për shtypin, për shkak se Qendra Kombëtare e Biznesit i bën të disponueshme të dhënat financiare të kompanive për vitin 2022 vetëm në gusht të vitit pasues. Për shkak të mungesës së të dhënave është e pamundur të vlerësohet nëse të ardhurat në sektorin e medias janë rritur apo kanë rënë gjatë vitit 2022. Sipas intervistave me informatorë kyç të tregut, viti 2022 ka shënuar amulli, pa ndryshime të mëdha në terma të numrit të gazetarëve apo profesionistëve të medias të punësuar dhe pa ndryshime në nivelin e pagave. Disa media në Shqipëri kanë punuar në drejtim të novacioneve përgjatë tre viteve të fundit përmes përdorimit të Raportimit nga Qytetarët e Angazhuar dhe formave të reja të monetizimit për të rritur qëndrueshmërinë, stabilitetin dhe të ardhurat<sup>[4]</sup>. Në të dhënat më të fundit të disponueshme nga viti 2021, tregohet një rritje me 30% në të ardhura në krahasim me vitin paraardhës në tregun e medias audiovizive si pasojë e një rritjeje nga fushatat e reklamave për zgjedhjet parlamentare të zhvilluara po atë vit. Supozohet se vitin 2022 duhet të ketë pasur një efekt korrektues në rënie në krahasim me një vit zgjedhor.



Treguesi i **Pavarësisë editoriale nga ndikimet komerciale dhe të pronarëve** mori vlerësimin 90% gjatë vitit 2022, duke u klasifikuar me rrezik të lartë. Sipas Indeksit të Lirisë së Medias (Reporterë pa Kufij 2022), gjatë vitit të kaluar grupe të biznesit të profilit të lartë në Shqipëri kanë rritur penetrimin e tyre ekonomik në tregun e medias ndërsa organizatat e medias dhe aktivistët kanë vijuar të ngrenë shqetësime mbi përdorimin e kanaleve të medias për të promovuar agjendat politike të pronarëve dhe interesat e tyre ekonomike, përfshirë evazionin fiskal. Sipas partnerëve të Platformës së Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve (2022), e cila publikoi një deklaratë në përfundim të një misioni faktmbledhës në nëntor 2022, gazetaria në Shqipëri është nën kërcënim si pasojë e kapjes së pjesëve të konsiderueshme të mjedisit të medias nga interesa të fshehta biznesi. Gjithashtu, raportet më të fundit mbi vendin të Komisionit Evropian (2022) dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit (2023), identifikojnë interesat e pronarëve të medias si kërcënimet kryesore kundrejt pavarësisë së medias në Shqipëri. Departamenti Amerikan i Shtetit vëren se shumica e mediave në Shqipëri janë nën pronësinë e biznesmenëve të mëdhenj me interesa të shtrira në shumë fusha, të cilët përdorin mediat e tyre për të përparuar interesat e tyre të tjera, përfshirë përfitimin e favoreve dhe promovimin e interesave të tyre të partitë politike. Në Shqipëri nuk ka skema të mbrojtjes shoqërore në rastet kur media ndryshon pronësinë apo vijën editoriale. Nuk ka masa rregulluese apo vetërregulluese në fuqi, për të siguruar që vendimi në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e kryeredaktorit nuk ndikohet nga interesat komerciale. Megjithëse Kodi i Etikës së Gazetarit thekson se media duhet të shmangë çdo konflikt interesi të shkaktuar nga interesat financiare, shumë pak media e respektojnë dhe e mbështesin këtë. Kodi i Etikës kërkon gjithashtu që përmbajtja editoriale duhet të dallojë qartazi nga reklamat; gjithsesi, në praktikë, reklamat e fshehura dhe mbivendosjet e produktit janë të gjithëpërhapura. Reklamat e fshehura publikohen në median online, në gazeta dhe në televizione.

### **Fokusi në mjedisin digjital**

Pluralizmi i Tregut shënoi një pikëzim prej 93.5% në mjedisin digjital, krahasuar me 85% për median në përgjithësi, duke u klasifikuar si me rrezik të lartë në mjedisin digjital.

Në Shqipëri nuk ka legjislacion të posaçëm mbi median vetëm digjitale dhe as ndonjë kërkesë specifike mbi publikimin e strukturës së pronësisë në një mënyrë të dedikuar dhe lehtësisht të aksesueshme, në regjistër apo databazë. Kërkesa e vetme është ajo e ngjashme me çdo biznes tjetër në vend, gjë që e bën të vështirë të identifikosh kompanitë dhe pronarët, veçanërisht kur ato janë pjesë e konglomerateve (Komisioni Evropian, 2022). Detyrimi i vetëm për median digjitale është që të identifikojë pronarin tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nëse ata regjistrojnë një domain me .al, gjë që mund të bëhet nga çdo individ apo entitet tregtar apo jofitimprurës (BIRN Albania, 2020).


Të dhënat mbi të ardhurat e medias digjitale në Shqipëri për vitin 2022 nuk janë të disponueshme, për shkak se regjistri i biznesit i bën të disponueshme të dhënat financiare të kompanive për vitin 2022 vetëm në gusht të vitit pasardhës. Për shkak të mungesës së të dhënave është e pamundur të vlerësohet nëse të ardhurat e sektorit të medias digjitale janë rritur apo kanë rënë gjatë vitit 2022. Në Shqipëri nuk ka raportime për iniciativa për zhvillimin e burimeve të reja të të ardhurave në median digjitale, të tilla si abonime apo reklama në Google. Në Shqipëri nuk ka masa parandaluese rregulluese për të ndaluar një shkallë të lartë përqendrimi në sektorin mediatik, sidomos mes llojeve të ndryshme të medias, të njohur si përqendrim vertikal (RSF, BIRN Albania, 2018).

Tregu i medias online në Shqipëri përbëhet nga një larmishmëri prej qindra entesh që operojnë vetëm në internet; gjithsesi, nuk ka të dhëna të disponueshme mbi ndarjen e tregut dhe të ardhurat. Shumica e mediave janë të vogla dhe shpesh thjesht kopjojnë dhe ripublikojnë përmbajtjen e faqeve

të tjera të medias tradicionale. Një sasi e konsiderueshme reklamash në tregun digjital shkon për Google dhe Meta. Gjithsesi, nuk ka të dhëna se sa e madhe është pjesa e tyre, për shkak se nuk janë të rregulluara apo të regjistruara te autoritetet fiskale vendase.

### 3.3. Pavarësia Politike (68% - rrezik i lartë)

Treguesit e Pavarësisë Politike masin ekzistencën dhe efikasitetin e masave mbrojtëse rregulluese dhe vetërregulluese kundër anësisë politike dhe ndikimeve politike mbi prodhimin e lajmeve, shpërndarjen dhe aksesin. Më specifikisht, kjo fushë synon të vlerësojë ndikimin e shtetit dhe, më në përgjithësi, të pushtetit politik mbi funksionimin e tregut të medias dhe pavarësisë së medias publike. Për më tepër, kjo fushë ka të bëjë me ekzistencën dhe efikasitetin e (vetër)regullimit në sigurimin e pavarësisë editoriale dhe disponueshmërisë së informacionit dhe këndvështrimeve politike të larmishme, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore.



Fusha e **Pavarësisë Politike** në përgjithësi shënoi një rrezik të lartë prej 68%, ndërsa rreziku më i lartë në këtë fushë lidhet me treguesit e Autonomisë Redaksionale dhe Pavarësisë Politike të Medias. Vlerësimi i kësaj fushe më 2022 ra me 1 pikë përqindjeje përkundrejt vitit 2021, kur ishte në masën 69%.

Treguesi i **Pavarësisë politike të medias** vlerësohet me rrezik të lartë me 85%. Ky tregues pati të njëjtin vlerësim më 2022 me vitin paraardhës. Në Shqipëri nuk ka masa të forta parandaluese që ta bëjnë postin zyrtar të papajtuësëm me pronësinë e medias apo të ndalojë pronarët e medias nga mbajtja e posteve në qeveri. Kontrolli i drejtpërdrejtë i medias audiovizive nga politikanët raportohet në disa raste, gjë që kontribuon në vlerësimin e këtij treguesi si me rrezik të lartë. Gjithsesi, edhe kur politikanët nuk kontrollojnë mediat drejtpërsëdrejti, ata sërish ushtrojnë ndikim nga pas skenave. Sipas organizatave ndërkombëtare të drejtave, pronarët e mediave në Shqipëri, shumë prej të cilëve kanë pronësi të ndërthurura në industri kyçe që mbështeten në prokurime publike, në mënyrë sistematike përdorin asetet e mediave të tyre për t'i shërbyer agjendave private apo politike dhe jo interesit publik. Sipas Indeksit të Lirisë së Shprehjes, mediat private më me ndikim në Shqipëri janë nën pronësi të një numri të vogël kompanish që kanë lidhje me politikanët dhe në të njëjtën kohë operojnë në sektorë shumë të rregulluar, të tilla si ndërtimi (Reporterët pa Kufij, 2022).

Treguesi i vlerësuar më negativisht në këtë fushë është **Autonomia Editoriale** me 97%. Ky tregues vlerësohet me rrezik të lartë për shkak se në Shqipëri nuk ka masa siguroese rregullatore në Ligjin e Medias Audiovizive në lidhje me emërimin e kryeredaktorit, ndërsa shtypi dhe media online nuk janë të rregulluara. Në praktikë, emërimet dhe shkarkimet e kryeredaktorëve nuk janë të pavarura nga ndikimet

politike. Më 2022, heqja nga puna e Sokol Ballës, kryeredaktorit të Top Channel, u konsiderua si e motivuar politikisht. Kjo ishte si rrjedhojë e një konflikti mes pronarëve të Top Channel dhe kryeministrit Edi Rama, i cili publikisht akuzoi televizionin për shantazh (Erebara, 2022c). Kodi i Etikës së Gazetarëve (Instituti Shqiptar i Medias 2018) përcakton pavarësi nga ndërhyrjet politike, por nuk është miratuar nga shumica e medias dhe nuk zbatohet në mënyrë efikase. Më 2020, 16 media nisën një mekanizëm për vetërregullim të quajtur Aleanca për Media Etike, por asnjë nga mediat kryesore në secilën kategori nuk bën pjesë në këtë aleancë (Safe Journalists Network, 2022b). Më 2022, aleanca rendit gjithsej 32 anëtarë, në televizion, shtyp dhe online (European Centre for Press and Media Freedom, 2022). Përmbajtja editoriale e mediave informative nuk konsiderohet si e lirë nga ndikimi politik. Megjithëse politikanët nuk kanë gjithmonë kontroll të drejtpërdrejtë mbi median në Shqipëri, ata sërish ushtrojnë kontroll jo të drejtpërdrejtë në politikën e saj editoriale dhe në përmbajtjen që gazetarët publikojnë apo transmetojnë. Pronarët e medias në Shqipëri përdorin median për të çuar përpara agjendën e vet politike dhe ekonomike, shpesh duke ndryshuar qëndrimin editorial për t'iu përshtatur narrativës së partisë në pushtet, politikanëve të opozitës apo interesave të fshehta të korporatave. Sipas Raportit për Praktikën e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri për vitin 2022, presioni politik, korrupsioni dhe mungesa e financimeve pengoi median e pavarur dhe gazetarët raportohet se ushtruan vetëcensurë (Departamenti Amerikan i Shtetit, 2023).

Treguesi mbi **Median audiovizive, platformat online dhe zgjedhjet** vlerësohet me rrezik të mesëm në masën 57% më 2022. Ky është i njëjti vlerësim me vitin 2021, për shkak të faktit se Shqipëria zhvilloi zgjedhje të pjesshme në vetëm gjashtë bashki në 2022 dhe vlerësimi i rrezikut në këtë tregues reflekton njëanësinë e shfaqur nga transmetuesi publik dhe stacionet kryesore televizive komerciale në Shqipëri gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021. Të dhëna të analizuara nga BIRN për kohën televizive që iu kushtua aktorëve politikë në kanalet kryesore PSM dhe në stacionet televizive private gjatë fushatës elektorale, tregojnë se pjesa më e madhe iu kushtua kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe anëtarëve të kabinetit të tij, si dhe dy partive të mëdha politike në vend, Partisë Socialiste dhe Partisë së qendrës së djathtë Demokratike. Partitë e vogla morën më pak se 5% të mbulimit të përgjithshëm në PSM (Likmeta, 2021). Gjithashtu, sa i përket zgjedhjeve të shkuara, shumica e stacioneve televizive vunë në shitje përmbajtjen e tyre editoriale dhe emisionet e debatit për aktorët politikë. Në të njëjtën kohë, qeveria qendrore, Bashkia e Tiranës dhe partitë politike, përfshirë opozitën, kanë institucionalizuar praktikën e regjistrimit paraprak apo përgatitjes së materialeve të gatshme, të cilat transmetohen dhe publikohen nga media pa imput të gazetarëve, kontroll editorial apo kuadrim (Safe Journalists Network, 2022b). Ka pasur raste kur gazetarëve u është mohuar e drejta për të raportuar nga ngjarjet gjatë zgjedhjeve dhe Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit të Zgjedhjeve raportoi se gazetarët mbetën vulnerabël ndaj presionit dhe korrupsionit (OSCE/ODHIR, 2021).

Treguesi i **Rregullimit shtetëror të burimeve dhe mbështetjes ndaj sektorit të medias** vlerësohet me rrezik të mesëm 58%. Ky tregues nuk ka regjistruar ndryshime në përqindje që nga viti 2021. Kjo renditje është kryesisht si pasojë e mungesës së rregullimit për të siguruar shpërndarje të ndershme të reklamave publike mes mediave. Reklamat publike nuk shpërndahen në mënyrë të drejtë nëpër media dhe nuk ka mekanizëm në fuqi për të garantuar që reklamat shtetërore të jenë në përputhje me përqindjet e tregut. Rregullat e prokurimit publik janë në përgjithësi të thjeshta dhe lënë shumë hapësirë për abuzime, veçanërisht për shkak se procedura lejon që kontratat e reklamave t'u jepen agjencive të reklamave, të cilat më pas mundet t'ia kalojnë kontratën dikujt tjetër pa qenë të detyruar të respektojnë ndonjë kriter specifik (RSF, BIRN Albania, 2018). Nuk ka ndonjë organ të mandatuar për të monitoruar këtë proces apo për të shpërndarë reklamat shtetërore. Një problem tjetër në lidhje me reklamat është që ato shpesh komisionohen në kontekstin e projekteve të ndryshme të zbatuara nga qeveria qendrore apo njësitë vendore dhe që nuk janë subjekt i asnjë rregulli prokurues. Institucione të tilla mund të kanalizojnë para për

mediat drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte përmes agjencive të reklamave apo palëve të treta. Këto transferta janë veçanërisht problematike, për shkak se marrin rolin e subvencionimeve në një mjedis ku nuk ka rregulla të qarta në shpërndarjen e reklamave shtetërore. Raporti më i fundit i Komisionit Evropian mbi Shqipërinë (2022) thotë se Tirana duhet të sigurohet që kërkesat për reklama publike të jenë të përafuara me standardet ndërkombëtare.


Treguesi i **Pavarësisë së medias publike** vlerësohet me rrezik të mesëm në masën 42%, gjë që është vlerësimi më i mirë i shënuar në fushën e Pavarësisë Politike. Ky tregues shënoi përmirësim për shkak të ndryshimeve në metodologji. Megjithëse ligji parashikon procedura të drejta dhe transparente të emërimit dhe shkarkimit të menaxhmentit të medias publike, ka pasur disa raste të ndërhyrjes politike në procedurë. Në mars 2022, parlamenti formalisht nisi procesin për të plotësuar dy vakanca në bordin mbikëqyrës të transmetuesit publik, i cili përbëhet nga 11 anëtarë. Vakancat nuk janë plotësuar ende. Gjatë një seance dëgjimore në komision në mars 2022, deputetët e mazhorancës dhe opozitës diskutuan haptazi për emërimin e anëtarëve të afiluar politikisht në bord, duke ngritur shqetësime për pavarësinë politike të PSM-së. Bordi emëron drejtorin e medias publike, por gjithashtu në teori mund të ndikojë edhe emërimin e redaktorëve. Transmetuesi publik i Shqipërisë mbetet i nënfinancuar, gjë që ngre shqetësimin se ai është i prekshëm nga ndikimi politik (Gjoka, 2022). Raportet e shoqërisë civile theksojnë se forma më e zakonshme e presionit politik ndaj PSM-së është indirekte, me partinë në pushtet të favorizuar sepse Këshilli Mbikëqyrës zgjidhet nga votat e shumicës në parlament (Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe të Medias, 2022), ndërsa disa nga anëtarët e rinj të bordit të transmetuesit publik të Shqipërisë konsiderohen nga aktorët politikë si njerëz me afilim të qartë politik (Erebara, 2021). Drejtori aktual i medias publike konsiderohet si njeri i afërt me Partinë Socialiste në pushtet, ndërsa drejtori i mëparshëm ka qenë kryeredaktor i gazetës së Partisë Socialiste në pushtet si dhe drejtues i departamentit të komunikimit në një qeveri të mëparshme socialiste.

### Fokusi në mjedisin digjital

Fusha e Pavarësisë Politike të mjedisin digjital u vlerësua me 97% më 2022, një diferencë prej 28 pikësh përqindjeje në krahasim me vlerësimin 69% për median në tërësi. Prania e kontrollit politik mbi median vetëm në internet vlerësohet si me rrezik të lartë. Në Shqipëri vlerësohet se ka rreth 900 media vetëm në internet, duke ngritur shqetësime mbi përhapjen e lajmeve të rreme që besohet se janë në përfitim të interesave specifike politike, financiare dhe kriminale (Departamenti Amerikan i Shtetit, 2023). Sipas raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, media digjitale është nën ndikim të fortë nga aktorët politikë, bizneset dhe nga palët e treta sa i përket financimeve dhe kontentit. Gjithsesi, pronësia e medias digjitale është shpesh opake.

### 3.4. Gjithëpërfshirja Sociale (71% - rrezik i lartë)

Gjithëpërfshirja Sociale është fusha që përqendrohet në aksesin në media të grupimeve specifike të një shoqërie: minoritetet, bashkësitë vendore apo rajonale, gratë dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Ky tregues ekzaminon gjithashtu mjedisin e njohurive mbi median të një vendi (edukimi mediatik), përfshirë aftësitë dixhitale të popullsisë së gjerë. Në fund, ai përfshin sfida të reja të shfaqura nga përdorimi i teknologjive digjitale, të cilat janë të lidhura me mbrojtjen kundër dizinformimit dhe gjuhës së urrejtjes.



Fusha e **Gjithëpërfshirjes Sociale** vlerësohet me rrezik të mesëm në 2022, një rritje me 8 pikë përqindjeje në krahasim me vitin e mëparshëm, nga 64% në 71%. Kjo zonë përfshin të vetmin tregues në MPM2023 për Shqipërinë që vlerësohet si me rrezik të ulët: Media lokale dhe komunitare. Ky tregues ishte i vetmi i vlerësuar me rrezik të ulët dhe për vitin e kaluar në Shqipëri.

Treguesi mbi **Përfaqësimin e minoriteteve në media** u vlerësua me 67% këtë vit, katër pikë përqindjeje më keq se sa më 2021. Ligji garanton akses në kohë transmetimi në PSM për pakicat e njohura ligjërisht dhe shumica e pakicave kanë akses të kufizuar në kohë transmetimi dhe raportim mbi to, me disa përjashtime<sup>[5]</sup>. Duke filluar nga viti 2018, ka një edicion lajmesh pesëminutësh në shtatë gjuhë në kanal in e dytë të PSM-së. Të dy minoritetet e përjashtuara janë egjiptianët, të cilët janë minoritet kulturor, por flasin shqip, dhe boshnjakët. Edicionet e lajmeve në serbisht dhe bullgarisht filluan në vitin 2020. Pavarësisht edicioneve të lajmeve, kanali i dytë i PSM-së mbulon tema të lidhura me minoritetet kryesore në programet e veta televizive. Gjithsesi, qëndrueshmëria e këtij projekti është e kërcënuar nga mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore të PSM-së dhe gazetarëve nga grupet e minoriteteve. Aktivistët e të drejtave të pakicave ankohen se përveç kohës së kufizuar të caktuar, edicionet e lajmeve janë thjeshtë përkthim i lajmeve të zakonshme në gjuhët e minoriteteve, por nuk reflektojnë shqetësime specifike apo ngjarje të lidhura me secilin prej këtyre grupeve. Për shembull, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Gjithëpërfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve parashikon tregues specifikë në këtë kontekst, një prej të cilëve është përgjegjësia e PSM-së për të prodhuar se paku 5 programe televizive dhe dokumentarë deri në vitin 2025, të cilat promovojnë kulturën rome dhe egjiptiane në mediat publike, në krahasim me zero (0) të shënuar në vitin 2020 (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2021). Në të njëjtën kohë, dy nga stacionet televizive rajonale të transmetuesit publik prodhojnë gjithashtu programe në gjuhët e minoriteteve

që janë dominuese në ato zona, kryesisht në bazë javore: maqedonisht dhe romisht për RTV Korça dhe greqisht dhe arumanisht për RTV Gjirokastra. Shumica e minoriteteve të njohura ligjërisht kanë pak akses në kohën e transmetimit në televizionet dhe radiot private. Nuk ka program në gjuhët e minoriteteve apo kushtuar një minoriteti specifik në dy televizionet dhe radiot më të mëdha komerciale të vendit.

Treguesi i **Barazisë gjinore në media** vlerësohet si me rrezik të lartë me 89% më 2022. Ky tregues është përmirësuar me një pikë përqindjeje në krahasim me vitin e mëparshëm. Ky tregues vlerësohet negativisht për një numër arsyesh. Transmetuesi publik, i cili duhet idealisht të udhëheqë në terma të gjithëpërfshirjes, nuk ka politikë për barazi gjinore. Në statutin e RTSH-së nuk ka parashikime në lidhje me barazinë gjinore në organet vendimmarrëse<sup>[6]</sup>. Më 2022, vetëm 20% e bordit menaxhues të RTSH-së ishin gra, ndërsa pjesa e grave mes drejtuesve ekzekutivë në median publike është zero. Pjesa e grave mes anëtarëve të bordit drejtues në kompanitë private televizive në Shqipëri është 17%; gjithsesi, të dy drejtorët ekzekutivë/administratorët e Top Channel dhe TV Klan, dy transmetuesit kryesorë të vendit, janë gra. Në kontrast, nuk ka gra mes kryeredaktorëve të mediave më të rëndësishme audiovizive, radiove, gazetave dhe mediave vetëm online. Të dhënat e monitorimit të medias vitin e kaluar kanë treguar se gratë janë më pak të përfaqësuara si në median audiovizive ashtu edhe në atë të shkruar. Të dhënat nga monitorimi i medias gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 tregojnë se burrat zunë 80.8% të kohës televizive ndërsa gratë vetëm 19.2%, megjithëse 39,8% e kandidatëve për deputetë në zgjedhje ishin gra (Likmeta, 2021). Një analizë e vitit 2022 nga BIRN tregon se në gjashtë nga emisionet televizive të debatit më të rëndësishme në televizionet shqiptare, vetëm 15% e të ftuarve ishin gra (Bezati, 2022). Në terma të përmbajtjes së artikujve të medias online, mes janarit 2020 dhe prillit 2022, e njëjta analizë zbuloi 320 raste shqetësuese abuzimesh seksuale në të cilat identifikohet viktimi, identifikohet familja, adresa e shtëpisë zbulohet dhe të dhëna të tjera personale publikohen. Projekti i ri mbi Kodin e Transmetimit, i cili po konsultohet nga AMA, synon të adresojë disa nga këto tema, veçanërisht në lidhje me përmbajtjen e programacionit në median audiovizive.

Treguesi i **Alfabetizimit Mediatik** u rendit me rrezik të lartë me 90%. Ky tregues ka shënuar rënie të fortë në krahasim me vitin 2021, kur ishte në masën 67%. Aktivitetet e alfabetizimit mediatik janë të kufizuara si në arsimimin formal ashtu edhe në atë joformal. Siç është përmendur nga Vibrant Information Barometer (IREX, 2022), qeveria shqiptare ka treguar shumë pak interes në promovimin e alfabetizimit të medias dhe informimit dhe aktivitetet kryesore janë ofruar nga projektet e shoqërisë civile, por me një numër të kufizuar përfituesish. Shqipëria renditet në vend të 33-të nga 35 vende evropiane në raportin e fundit mbi indeksin e alfabetizimit mediatik, duke lënë pas vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut (Open Society Institute, 2021). Gjithashtu, besimi te media ka vijuar të përkeqësohet përgjatë viteve të fundit në Shqipëri, me vetëm 47% të shtetasve që i besojnë ato më 2022 (Regional Cooperation Council, 2022).

Treguesi i **Medias vendore/rajonale dhe komunitare** mori vlerësimin 31%, me rrezik të ulët më 2022. Ky vlerësim ishte i njëjtë me vitin 2021. Autoriteti i Medias Audiovizive i jep mediave lokale dhe rajonale akses në infrastrukturë dhe në frekuencat TV dhe Radio pas përfundimit të procesit të digjitalizimit nga transmetimi analog tek ai numerik. Nuk ka subvencione nga shteti për median lokale në Shqipëri. Megjithëse transmetuesi publik nuk detyrohet me ligj të mbajë korrespondentë lokalë apo rajonalë të vetët në degët e tij, statuti thotë se PSM duhet të mbajë katër programe/degë rajonale, pa specifikuar cilat. PSM ka katër transmetues vendorë, RTSH Kukësi, RTSH Shkodra, RTSH Gjirokastra dhe RTSH Korça, të cilat kanë program ditor. Aktualisht në Shqipëri ka katër stacione radioshoqërore të lidhura me organizatat fetare: Radio Spektrum - Komuniteti Mysliman; Radio Dodona - Komuniteti Bektashi; Radio Maria - Fondacioni Radio Maria dhe Radio Ngjallja - Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë<sup>[7]</sup>. Nuk ka të dhëna të raportuara për dhunim të pavarësisë së tyre.

Treguesi i **Mbrojtjes kundër dizinformimit dhe gjuhës së urrejtjes** u rendit i lartë me 67% më 2022. Ky tregues ka shënuar rritje me pesë pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2021. Arsyeja se pse ky tregues është renditur si i lartë është fakti që Shqipëria nuk ka një strategji efektive për të trajtuar dezinformimin. Kuadri ligjor nuk ka rregullore specifike për dizinformimin në Shqipëri dhe as nuk ka një përdorim të drejtpërdrejtë të këtij termi apo një përkufizim ligjor se çfarë është dizinformimi. Gjithsesi, Kodi Penal rregullon përhapjen e informacionit të rremë me qëllim shkaktimin e panikut (neni 267) apo për pengimin e qëllimshëm të efikasitetit të njësive të emergjencës (neni 271) ndërsa Kodi i Etikës përfshin parashikime të përgjithshme mbi saktësinë e informacionit dhe raportimit bazuar në fakte, të cilat mund të konsiderohen pjesërisht si udhërrëfyese në këtë drejtim (Instituti Shqiptar i Medias, 2018). Ka disa iniciativa të pavarura për kontrollimin e fakteve me standarde të larta profesionale dhe etike që po punojnë kundër dezinformimit, por impakti tyre është i kufizuar për shkak të burimeve të pakta në fonde dhe në njerëz. Megjithatë ka deklarata të vazhdueshme publike apo referenca për lajme të rreme dhe dezinformim, nuk ka pasur iniciativa specifike të centralizuara në lidhje me rregullimin e dezinformimit. Në kontrast, amendimet më të fundit në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>[9]</sup>, miratuar në fund të vitit 2020, futën përkufizimin e parë të “gjuhës së urrejtjes” në kuadrin ligjor shqiptar, duke njohur atë si formë diskriminimi. Pavarësisht kuadrit ligjor dhe faktit që raportet më të fundit të shoqërisë civile theksojnë pjesën e madhe të njerëzve që raportojnë raste të gjuhës së urrejtjes në programet televizive (kryesisht në emisionet e debatit politik), numri i ankesave të dorëzuara kundër gjuhës së urrejtjes në Këshillin e Ankesave në Autoritetin e Medias Audiovizive dhe në Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbetet shumë i ulët.

### **Fokusi në mjedisin digjital**

Shqipëria ka përqindjen më të ulët të popullsisë (23.80%) që ka aftësi bazë apo mbi nivelin bazë për fushën digjitale mes 36 vendeve Evropiane (Eurostat, 2021). Mbrojtja nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes është e dobët dhe mbetet e kufizuar. Raporti më i fundit i vendit thekson se dizinformimi, përfshirë fushatat shpifëse janë të përsëritura, veçanërisht në median online, ku vetërregullimi duhet të sigurohet (Komisioni Evropian, 2022). Megjithatë ka mekanizma ekzistues rregullues dhe vetërregullues për të raportuar rastet e gjuhës së urrejtjes në internet, efikasiteti i tyre është i kufizuar. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese në media, veçanërisht online, kundër anëtarëve të komunitetit trans vijon të mbetet një problem.



## 4. Konkluzione

### Mbrojtja Themelore

- **Shqipëria duhet të bëjë më shumë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes duke zbatuar legjislacionin aktual.** Çdo ndryshim në kuadrin ligjor aktual duhet të konsultohet me aktorët mediatikë dhe duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të lirisë së medias. Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë më shumë për të hetuar rastet e sulmeve fizike kundër gazetarëve. Komuniteti i medias dhe organizatat e gazetarëve duhet të bëjnë më shumë për të reaguar ndaj fushatave shpifëse kundër gazetarëve, si në internet ashtu edhe jashtë, të cilat shpesh vijnë nga rangjet më të larta të pushtetit.
- **Më shumë përpjekje duhet të bëhen për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit për të Drejtën për Informim.** Në të njëjtën kohë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të sanksionojë zyrtarët që në mënyrë të përsëritur mohojnë apo kufizojnë aksesin në të dhëna dhe në dokumente zyrtare në një mënyrë arbitrare.
- **Më shumë përpjekje duhen bërë për të rritur standardet e gazetarëve dhe në garantimin e pavarësisë redaksionale.** Shoqatat profesionale dhe këshilli i medias duhet të forcojnë advokimin e tyre për pavarësinë editoriale dhe respektin për standardet profesionale.
- **Udhëheqësit politikë duhet të shmangin gjuhën nxitëse** dhe sulmet kundër medias dhe gazetarëve.

### Pluralizmi i Tregut

- Mungesa e të dhënave mbi përqendrimin e tregut dhe të audiencës në televizion, radio, print dhe në tregun digjital e bën të pamundur vlerësimin e pluralizmit të skenës mediatike në Shqipëri. **Autoriteti i Medias apo shoqatat profesionale duhet të luajnë një rol në mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave mbi audiencën të mediave audiovizuale mbi tregun e reklamave.** Organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe ekspertët duhet të bëjnë një përpjekje për të përditësuar bazën e të dhënave dhe mekanizmin e pluralizmit mediatik, të tilla si Monitori i Pronësisë së Medias, MOM.
- **Organet rregullatore dhe mekanizmat vetërregullues duhet të bëjnë më shumë për të kufizuar ndikimin e entiteteve komerciale të pronarëve të medias në përmbajtjen e medias.** Autoriteti i Konkurrencës duhet të vlerësojë rastet e përqendrimit vertikal në tregun e medias.

### Pavarësia Politike

- **Duhet të bëhen përpjekje për të forcuar pavarësinë editoriale** duke siguruar që emërimi dhe shkarkimi i redaktorëve dhe i kryeredaktorëve të mos ndikohet politikisht.
- **Duhet të hartohen rregullore mbi mënyrën e shpërndarjes së reklamave qeveritare** me qëllim që të kufizohet ndikimi i politikanëve dhe partive politike në media.
- **Masa më të forta parandaluese rregullatore duhet të ndërmerren** në mënyrë që postet qeveritare të jenë të papajtueshme me pronësinë e medias.

- **Politikanët duhet të shmangin praktikën e institucionalizuar të regjistrimit paraprak apo përgatitjes së materialeve të gatshme** të cilat transmetohen dhe publikohen nga media pa input gazetaresk gjatë ose ndërmjet fushatave elektorale.

## Gjithëpërfshirja Sociale

- **Përfaqësimi i grave në media mbetet i ulët dhe duhet të bëhet për të krijuar balancë më të madhe gjinore në bordet e menaxhimit dhe të promovojë gazetaret dhe redaktoret drejt pozicioneve drejtuese.** Gjithashtu, media komerciale duhet të ofrojë hapësirë për komunitetet etnike dhe kulturore, veçanërisht në për shkak se kanalet e PSM-së kanë audiencë të ulët.
- **Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për të zhvilluar dhe shpërndarë të dhëna më të plota mbi politikat e alfabetizimit mediatic dhe kurrikullave për arsimimin parauniversitar,** mbështetur nga trajnimi i duhur i mësuesve dhe vendosja e burimeve të mjaftueshme në dispozicion. Klasat e alfabetizimit të medias në arsimin parauniversitar duhet të bëhen të detyrueshme për nxënësit.
- **Më shumë financime duhet të vihen në dispozicion për të luftuar dizinformimin dhe gjuhën e urrejtjes,** përmes forcimit të iniciativave të kontrollit të fakteve dhe monitorimit të shpërndarjes së narrativave dezinformuese vendëse ose të huaja në media.
- **Mekanizmat rregulluese dhe vetërregulluese për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën diskriminuese** në sferën digjitale duhet të forcohen dhe zgjerohen, veçanërisht për të kundërshtuar gjuhën e urrejtjes kundër grupeve të marginalizuara dhe pakicat gjinore.

## 5. Shënime

- [1] Ligji nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.  
<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>
- [2] Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i amenduar.  
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/03/04/97-2013>
- [3] Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/514>
- [4] Informacion mbi projektin 'Media for All' dhe rezultatet e tij:  
<https://www.britishcouncil.al/en/programmes/society/media-for-all>
- [5] Ligji nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.  
<https://www.kmd.al/wpcontent/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-PakicaveKombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>
- [6] Vendim nr. 98/2016 i Kuvendit të Shqipërisë mbi “Statutin e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”.  
[https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/cf4f4293531344ad9af0cbaccd1e078\\_202004071650.pdf](https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/cf4f4293531344ad9af0cbaccd1e078_202004071650.pdf)
- [7] Lista e pëditësuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive mbi mediat e licensuara në vend:  
<http://ama.gov.al/service-media-providers/?lang=en>
- [8] Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.  
<https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>
- [9] Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar.  
<https://www.kmd.al/wpcontent/uploads/2021/05/2.pdf>

## 6. Referenca

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (2023). Coronavirus Albania: Statistika. <https://coronavirus.al/statistika/>
- Albanian Helsinki Committee (2022). *Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri Për vitin 2021*. [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi\\_Tetor-2022-KShH.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf)
- Albanian Media Institute (2018). *Kodi i Etikës së Gazetarit*. <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>
- Bezati, V. (2022, May 27). *Women in Albanian Media: From Secondary Victimization to ‘Slut-Shaming’*. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2022/05/27/women-in-albanian-media-from-secondary-victimisation-to-slut-shaming/>
- BIRN Albania (2020). *Internet Governance in Albania and Its Role on Media Freedom*. <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1-1.pdf>
- Council of Europe (2023). Safety of Journalists Platform. <https://fom.coe.int/en/alerte>
- Erebara, Gj. (2022a, December 30). *Viti 2022: Sprova e betejës antikorrupsion në Shqipëri*. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2022/12/30/viti-2022-sprova-e-betejes-antikorrupsion-ne-shqiperi/>
- Erebara, Gj. (2022c, November 2). *Albania PM Accuses Media of ‘Blackmail’ With Negative Coverage*. *Balkan Insight*. <https://www.reporter.al/2022/09/23/zgjedhjet-e-vitit-2021-shtuan-biznesin-e-televizioneve-ne-shqiperi/>
- Erebara, Gj. (2022b, September 23). *Zgjedhjet e vitit 2021 shtuan biznesin e televizioneve në Shqipëri*. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2022/09/23/zgjedhjet-e-vitit-2021-shtuan-biznesin-e-televizioneve-ne-shqiperi/>
- Erebara, Gj. (2021, May 24). *Albania Parliament’s Race to Fill Media Board Causes Alarm*. *Balkan Insight*. <https://balkaninsight.com/2021/05/24/socialists-hurry-to-elect-media-board-alarm-experts/>
- European Bank of Reconstruction and Development (2023). *Transition Report 2022-2023: Country Assessment Albania*. <https://2022.tr-ebd.com/countries/#>
- European Centre for Press and Media Freedom (2023). *Mapping Media Freedom*. <https://www.ecpmf.eu/monitor/mapping-media-freedom/>
- European Centre for Press and Media Freedom (2022). *Albania: Media pluralism and transparency concerns fuel deterioration in media freedom*. <https://www.ecpmf.eu/albania-media-pluralism-and-transparency-concerns-fuel-deterioration-in-media-freedom/>
- European Commission (2022). *Albania 2022 Report*. <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>
- Eurostat (2021). *Individuals’ level of digital skills*. [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/isoc\\_sk\\_dskl\\_i21/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/isoc_sk_dskl_i21/default/table?lang=en)
- Gjoka, B. (2022, March 3). *Politizimi i RTSH-së, PS e PD diskutojnë ndarjen e “tortës” në Këshillin Drejtues*. *Reporter.al*. <https://www.reporter.al/2022/03/16/politizimi-i-rtsh-se-ps-e-pd-diskutojne-ndarjen-e-tortes-ne-keshillin-drejtues/>
- INSTAT (2023). *Survey on Information and Communication Technologies (ICT) usage in Households and by Individuals in 2022*. <https://www.instat.gov.al/media/11169/ict-2022-english.pdf>
- INSTAT (2012). *Population and Housing Census 2011*. [http://www.instat.gov.al/media/3058/main\\_results\\_population\\_and\\_housing\\_census\\_2011.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf)
- IREX (2022). *Albania: Vibrant Information Barometer 2022*. <https://www.irex.org/files/vibrant-information-barometer-2022-albania>
- Likmeta, B. (2021, June 2). *Albanian Election Commissioner Turns Blind Eye to Broadcast Bias*. *Balkan Insight*.

<https://balkaninsight.com/2021/06/02/albanian-election-commissioner-turns-blind-eye-to-broadcast-bias/>  
Media Freedom Rapid Response (2023). *Mapping Media Freedom Monitoring Report 2022*.  
<https://www.mappingmediafreedom.org/wp-content/uploads/2023/02/MFRR-Monitoring-Report-2022.pdf>  
Ministry of Health and Social Protection (2021). *The National Action Plan for Equality, Inclusion and Participation of Roma and Egyptians in Albania (2021-2025)*. <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/NATIONAL-ACTION-PLAN-FOR-EQUALITY.pdf>  
Open Society Institute (2021). *Media Literacy Index 2021. Double Trouble: Resilience to Fake News at the Time of Covid-19 Infodemic*. [https://osis.bg/wp-content/uploads/2021/03/MediaLiteracyIndex2021\\_ENG.pdf](https://osis.bg/wp-content/uploads/2021/03/MediaLiteracyIndex2021_ENG.pdf)  
OSCE/ODIHR (2021). *Parliamentary Elections 25 April 2021: ODIHR Limited Election Observation Mission - Final Report*. <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf>  
Regional Cooperation Council (2022). *Balkan Barometer 2022*. <https://wbc-rti.info/object/document/23171>  
Reporter Without Borders (2022). *Freedom of the Media Index*. <https://rsf.org/en/albania>  
Reporters Without Borders, BIRN Albania (2018). *Media Ownership Monitor-Albania*. <http://albania.mom-rsf.org/>  
SafeJournalists Network (2022a). *SJ: The Prime Minister of Albania banned a journalist to attend press conferences*.  
<https://safejournalists.net/portfolios/sj-the-prime-minister-of-albania-banned-the-journalist-to-attend-press-conferences/>  
SafeJournalists Network (2022b). *Western Balkans Journalists' Safety Index Narrative Report Albania 2021*.  
[https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2022/12/Index-2021\\_Narrative-Report-Albania-2021\\_Eng.pdf](https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2022/12/Index-2021_Narrative-Report-Albania-2021_Eng.pdf)  
United States Department of State (2023). *2022 Country Reports on Human Rights Practices: Albania*.  
<https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>  
Venice Commission (2020). *Opinion on draft amendments to law n°97/2013 on the audiovisual media service*. <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-0620/16809ec9c9>

## ANEKSE I. EKIPI I STUDIMIT KOMBËTAR

Emri	Mbiemri	Pozicioni	Institucioni	MPM2023 CT Kryesues
<i>Kristina</i>	<i>Voko</i>	<i>Drejtoreshë Ekzekutive</i>	<i>Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri</i>	X
<i>Besar</i>	<i>Likmeta</i>	<i>Kryeredaktor</i>	<i>Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri</i>	

## ANEKSE II. GRUPI I EKSPERTËVE

Grupi i Ekspertëve përbëhet nga specialistë me njohuri thelbësore dhe përvojë të njohur në fushën e medias. Roli i Grupit të Ekspertëve ishte të rishikonte përgjigjet e ekipit të vendit për 16 variabla nga 200 që përbëjnë MPM2023. Konsultimi i këndvështrimit të ekspertëve të njohur synon maksimizimin e objektivitetit të përgjigjeve dhënë variabla, vlerësimi i të cilave mund të konsiderohet si subjektive, duke siguruar saktësinë e rezultateve përfundimtare të MPM. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se raporti përfundimtar i vendit nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet individuale të ekspertëve që morën pjesë. Ajo përfaqëson vetëm pikëpamjet e ekipit kombëtar të vendit që ka kryer mbledhjen e të dhënave dhe janë autorë të raportit.

Emri	Mbiemri	Pozicioni	Institucioni
<i>Mimoza</i>	<i>Kociu</i>	<i>Coordinator</i>	<i>Association of Professional Journalists of Albania</i>
<i>Koloreto</i>	<i>Cukali</i>	<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	<i>Këshilli Shqiptar i Medias</i>
<i>Brejdon</i>	<i>Xhavara</i>	<i>Journalist   Minority Right's activist</i>	<i>COMMUNITY REPORTERS ALBANIA</i>
<i>Blerjana</i>	<i>Bino</i>	<i>Kerkuese për Shqipërinë</i>	<i>Safe Journalists</i>
<i>Nilian</i>	<i>Lole</i>	<i>Kryeredaktor</i>	<i>Radio Televizioni Shqiptar</i>
<i>Glorian</i>	<i>Tusha</i>	<i>Specialist pranë Drejtorisë Juridike dhe Integritit</i>	<i>Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare</i>

# Raporti i Projektit Studimor

Edicioni -

Qershor 2023



Publications Office  
of the European Union

